

VENDIM
Nr. 1, datë 17.10.2023

PËR ZGJEDHJEN E Z. SOKOL SADUSHI KRYETAR I GJYKATËS SË LARTË

Mbledhja e Përgjithshme e Gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, e përbërë nga gjyqtarët:

Medi Bici	kryetar;
Sokol Sadushi	anëtar;
Artur Kalaja	anëtar;
Ilir Panda	anëtar;
Ervin Pupe	anëtar;
Sokol Binaj	anëtar;
Albana Boksi	anëtare
Sandër Simoni	anëtar;
Asim Vokshi	anëtar;
Arbena Ahmeti	anëtare;
Gentian Medja	anëtar;
Darjel Sina	anëtar;
Sokol Ngresi	anëtar;
Margarita Buhali	anëtare;
Enton Dhimitri	anëtar;
Vojsava Kola	anëtare;
Valbon Çekrezi	anëtar;
Enkelejda Metaliaj	anëtare,

në mbledhjen e datës 17.10.2023, e cila kishte në rend të ditës zhvillimin e procedurës për zgjedhjen e kryetarit të Gjykatës së Lartë,

VËREN:

1. Sipas nenit 51, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar), kryetari i Gjykatës së Lartë zgjidhet nga Mbledhja e Përgjithshme e Gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë për një periudhë 3-vjeçare (trevjeçare) pa të drejtë rizgjedhjeje.

2. Në bazë të pikës 9, të nenit 51, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar), Këshilli i Lartë Gjyqësor miratoi vendimin nr. 485, datë 21.9.2023, “Për miratimin e rregullave për zgjedhjen e kryetarit të Gjykatës së Lartë”, me të cilin u përcaktuan në mënyrë të detajuar procedurat dhe afatet e zhvillimit të procesit të zgjedhjes së kryetarit të Gjykatës së Lartë.

3. Më datë 2.10.2023, zëvendëskryetari i Gjykatës së Lartë u dërgoi gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë ftesën për paraqitjen e kërkesës për shprehjen e interesit për pozicionin e kryetarit të Gjykatës së Lartë. Afati për paraqitjen e kërkesës për shprehjen e interesit ishte deri më datë 12.10.2023.

4. Në përfundim të këtij afati, rezultoi se kishte paraqitur kërkesë për shprehjen e interesit për pozicionin e kryetarit të Gjykatës së Lartë, gjyqtari Sokol Sadushi.

5. Nisur nga fakti se zëvendëskryetari i Gjykatës së Lartë, z. Sokol Sadushi kishte paraqitur kërkesë për shprehjen e interesit për pozicionin e kryetarit të Gjykatës së Lartë, në bazë të pikës 2, të nenit 4, të vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 485, datë 21.9.2023, “Për miratimin e rregullave për zgjedhjen e kryetarit të Gjykatës së Lartë”, procesi i zgjedhjes së kryetarit të Gjykatës së Lartë dhe Mbledhja e Përgjithshme e Gjyqtarëve u drejtua nga gjyqtari Medi Bici, i cili është gjyqtari me përvojën profesionale më të gjatë si gjyqtar i Gjykatës së Lartë.

6. Referuar pikës 9 të vendimit nr. 485, datë 21.9.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, “Për miratimin e rregullave për zgjedhjen e kryetarit të Gjykatës së Lartë”, gjyqtari Medi Bici, me shkresën nr. 5306, datë 12.10.2023, iu drejtua Këshillit të Lartë Gjyqësor, me anë të së cilës i kërkoi informacion për kandidatin lidhur me plotësimin e kushteve ligjore të përcaktuar në pikën 2, të nenit 51, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar).

7. Këshilli i Lartë Gjyqësor, me shkresën nr. 5325/1, datë 13.10.2023, paraqiti informacion e kërkuar për kandidatin lidhur me plotësimin e kushteve ligjore.

8. Gjyqtari Medi Bici, pasi konstatoi se kandidati Sokol Sadushi ka paraqitur kërkesën dhe platformën konform rregullave dhe se ai i plotëson kushtet ligjore për t’u zgjedhur kryetar i Gjykatës së Lartë, vijoi me zhvillimin e procesit të zgjedhjes së kryetarit të Gjykatës së Lartë.

9. Me shkresën nr. 2, datë 13.10.2023, gjyqtari Medi Bici njoftoi thirrjen e Mbledhjes së Përgjithshme të Gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë për zgjedhjen e kryetarit të Gjykatës së Lartë, më datë 17.10.2023, ora 9:00, si dhe shpërndau listën me emrin e kandidatit që ka shprehur interes për pozicionin e kryetarit të Gjykatës së Lartë.

10. Në bazë të vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 485, datë 21.9.2023, “Për miratimin e rregullave për zgjedhjen e kryetarit të Gjykatës së Lartë”, aneksi nr. 3 i tij, u përgatit fleta e votimit që përmbante vetëm emrin e kandidatit Sokol Sadushi.

11. Në Mbledhjen e Përgjithshme e Gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, të mbajtur më datë 17.10.2023, ora 9:00, morën pjesë të gjithë gjyqtarët e Gjykatës së Lartë (18 gjyqtarë), duke plotësuar kuorumin e nevojshëm për vlefshmërinë e mbledhjes dhe realizimin e procesit të zgjedhjes së anëtarit të Gjykatës Kushtetuese.

12. Referuar vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, nr. 485, datë 21.9.2023, “Për miratimin e rregullave për zgjedhjen e kryetarit të Gjykatës së Lartë”, procesi i votimit u administrua nga komisioni i votimit, në përbërje të të cilit ishin kancelarja në detyrë e Gjykatës së Lartë, kryesekretari dhe sekretari gjyqësor me përvojën më të gjatë në Gjykatën e Lartë.

13. Në përfundim të procesit të votimit, komisioni i votimit, pas numërimit të fletëve të votimit, shpalli numrin e votave të marra nga kandidati, nga ku rezultoi se kandidati z.Sokol Sadushi mori 17 (shtatëmbëdhjetë) vota.

14. Referuar pikës 6, të nenit 51, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar), për zgjedhjen e kryetarit të Gjykatës së Lartë nevojitet shumica absolute e votave e të gjithë anëtarëve të Mbledhjes së Përgjithshme të Gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë (minimumi 10 vota). Në kushtet kur gjyqtari Sokol Sadushi mori 17 vota, ai konsiderohet se ka arritur shumicën e votave të kërkuara nga ligji për t’u zgjedhur kryetar i Gjykatës së Lartë.

PËR KËTO ARSYE,

Në mbështetje të pikës 6, të nenit 51 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar), referuar rezultatit të votimit, Mbledhja e Përgjithshme e Gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë,

VENDOSI:

1. Zgjedhjen e z. Sokol Sadushi kryetar i Gjykatës së Lartë, me mandat 3-vjeçar (trevjeçar), deri në vitin 2026.

2. Ky vendim i dërgohet Presidentit të Republikës, Këshillit të Lartë Gjyqësor, kryetarit të Kuvendit, Gjykatës Kushtetuese dhe prokurorit të përgjithshëm.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

4. Vendimi botohet në Fletoren Zyrtare, si dhe në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë.

Kryetar: Medi Bici

Anëtarë: Ilir Panda, Sokol Sadushi, Artur Kalaja, Sokol Binaj, Ervin Pupe, Albana Boksi, Asim Vokshi, Sandër Simoni, Darjel Sina, Gentian Medja, Arbena Ahmeti, Valbon Çekrezi, Margarita Buhali, Vojsava Kola, Enton Dhimitri, Enkelejda Metaliaj, Sokol Ngresi